



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “GJEOGRAFI”

ARSIMI I MESËM I ULËT

KLASA 6

FUSHA “SHKENCAT SHOQËRORE”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Evis Mastori



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	4
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	6
	2.1 Objektivat e përgjithshme të gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët.....	6
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA.....	9
	4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.....	9
	4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjeografisë.....	13
	4.3 Kompetencat e lëndës së gjeografisë dhe rezultatet e të nxënit	16
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	21
	5.1 Koha mësimore për secilën tematikë/nëntematikë për klasën e gjashtë	21
	5.2 Përmbajtja e klasës së gjashtë	22
	5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.	29
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	34

6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë	37
6.2	Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjeografisë	38
6.3	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë	40
6.4	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë	42
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	43
7.1	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	47
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	49
9	REKOMANDIME TË TJERA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	51
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE	56

1 HYRJE

Gjeografia është shkenca që studion Tokën, natyrën dhe mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe ndikojnë në mjedisin përreth tyre. Ajo shqyrton mjedisin natyror përfshirë relievin, klimën, ujërat, tokën, bimësinë dhe botën shtazore; veprimtarinë njerëzore, përfshirë popullsinë, vendbanimet, ekonominë, trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe mënyrën se si njerëzit ndikojnë dhe ndërveprojnë me mjedisin. Gjeografia analizon shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, ndryshimet e tyre në kohë dhe hapësirë. Ajo luan një rol të rëndësishëm në kuptimin e problemeve mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, duke ndihmuar në analizën e ndërveprimeve midis shoqërisë dhe mjedisit.

Si lëndë e fushës së shkencave shoqërore, gjeografia është pjesë përbërëse e kurrikulës bërthamë në arsimin e mesëm të ulët dhe kontribuon në formimin e përgjithshëm të nxënësit.

Përmes mëimit të gjeografisë, nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të kuptojnë karakteristikat natyrore dhe shoqërore të hapësirës gjeografike, larmishmërinë e vendeve dhe rajoneve, kulturat dhe mënyrat e jetesës, ndërvarësinë midis njerëzve dhe mjedisit, dhe të zhvillojnë një perspektivë të gjerë dhe të informuar për botën, duke përfshirë dimensionin lokal, kombëtar, rajonal dhe global.

Në këtë kontekst, gjeografia luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e nxënësve për të kuptuar botën komplekse ku jetojnë, për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën shoqërore dhe për të ndërtuar një identitet të qëndrueshëm personal, shoqëror dhe kombëtar.

Gjithashtu, gjeografia kontribuon në edukimin për bashkëjetesën, përgjegjësinë qytetare dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke u ofruar nxënësve mjetet për të kuptuar sfidat mjedisore dhe për të reflektuar mbi mënyrat e bashkëjetesës harmonike me natyrën dhe me njëri-tjetrin.

Programi i gjeografisë në arsimin bazë është ndërtuar mbi parimin e zhvillimit të kompetencave kyçe, të cilat janë themelore për të nxënë gjatë gjithë jetës. Përmbajtja mësimore nuk ofrohet si qëllim në vetvete, por si mjet për ndërtimin e njohurive të zbatueshme në situata konkrete të të

nxënit. Nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese, të analizojë dhe të zgjidhë probleme gjeografike duke përdorur mjetet gjeografike, si hartat, diagramet, të dhënat statistikore, platformat digjitale etj.

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë, puna në terren, analiza e shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore dhe interpretimi i ndërvarësisë mes tyre, janë ndër veprimtaritë që zhvillojnë aftësitë themelore gjeografike të nxënësit. Përmes tyre, nxënësi mëson të ndërtojë kuptime më të thella për vendin ku jeton dhe për botën në tërësi.

Hartimi i programit të gjeografisë mbështetet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Planin Mësimor të Arsimit Bazë.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i mësimi të gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë botën në të cilën jetojnë, nga vendbanimi i tyre lokal, deri te hapësira globale, përmes një analize të ndërveprimit mes faktorëve natyrorë dhe shoqërorë. Mësimi i kësaj lënde synon zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që i ndihmojnë nxënësit të bëhen qytetarë të ndërgjegjshëm, të aftë për të kuptuar dhe përballuar sfidat mjedisore dhe shoqërore, si dhe për të kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme. Gjeografia luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për të kuptuar diversitetin natyror e kulturor dhe për të zhvilluar ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe çështjeve globale.

2.1 Objektivat e përgjithshme të gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët

Në përfundim të arsimit të mesëm të ulët, nxënësi do të jetë i aftë:

- të zhvillojë njohuri dhe të kuptojë karakteristikat themelore të mjedisit natyror dhe shoqëror, si dhe ndërveprimet midis tyre në nivele të ndryshme (lokal, rajonal, kombëtar dhe global);
- të kuptojë ndërlidhjen midis dukurive natyrore dhe proceseve gjeofizike që ndikojnë në formimin e peizazheve, pasurive natyrore, klimës dhe mjedisit të planetit Tokë;
- të vëzhgojë, të mbledhë dhe të analizojë të dhëna gjeografike; të interpretojë harta, grafikë dhe burime të tjera vizuale apo të shkruara, duke zhvilluar aftësi për të menduar në mënyrë të pavarur dhe logjike;
- të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, të vendeve të tjera, njerëzve dhe mënyrës si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;

- të identifikojë veçoritë natyrore, ekonomike, kulturore dhe shoqërore të vendeve dhe rajoneve të ndryshme dhe ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së popullsisë dhe zhvillimin rajonal;
- të ndërgjegjësohet për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillojë qëndrime dhe sjellje të përgjegjshme ndaj përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- të kuptojë rolin e tij si qytetar në një shoqëri të ndërlidhur globalisht dhe të zhvillojë qëndrime respektuese ndaj diversitetit dhe bashkëjetesës paqësore;
- të zotërojë terminologjinë dhe mjetet specifike të gjeografisë, duke i zbatuar në situata të ndryshme të të nxënit dhe të jetës së përditshme;
- të lidhë njohuritë gjeografike me fusha të tjera të dijes, duke përdorur qasjen ndërdisiplinore;
- të punojë në mënyrë bashkëpunuese dhe efektive në zgjidhjen e problemeve përmes projekteve, detyrave në grup dhe diskutimeve të strukturuar;
- të zhvillojë vetëbesim, këmbëngulje dhe një qëndrim pozitiv ndaj sfidave, duke kuptuar rëndësinë e të menduarit gjeografik në jetën e përditshme dhe në orientimin profesional;
- të kuptojë dhe të zbatojë mënyra etike dhe të përgjegjshme të përdorimit të teknologjisë gjatë përmbushjes së detyrave mësimore dhe kërkimeve gjeografike.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë gjeografike në mënyrë funksionale dhe të ndërgjegjshme në jetën e tyre të përditshme.

Diagrama 1. Përmbajtja e programit lëndor të gjeografisë



4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Lënda e gjeografisë kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe dhe aftësive të shekullit 21-të, si: të menduarit kritik e krijues, zgjidhja e problemeve, aftësitë e bashkëpunimit, aftësitë digjitale etj. Përmes përmbajtjes së saj, gjeografia ndihmon në formimin e qytetarit të aftë për të analizuar proceset natyrore dhe shoqërore, për të kuptuar marrëdhëniet midis njeriut dhe mjedisit, dhe për të marrë vendime të informuara në jetën e përditshme.

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Në tabelën e mëposhtme përshkruhen rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që nxënësi zhvillon në klasën e gjashtë në lëndën e gjeografisë.

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> • komunikon në mënyrë efektive si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar; • përshtat komunikimin me situatat dhe qëllimet; • kërkon, mbledh dhe përpunon informacione me mjete ndihmëse;	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> • fillon, ndjek dhe përfundon biseda të thjeshta për tema të ndryshme;

• formulon dhe shpreh argumente me gojë dhe shkrim; • transmeton saktë të dhënat e mbledhura në forma të ndryshme; • prezanton projekte dhe tema përmes komunikimit verbal dhe elektronik; • përshkruan ngjarje duke ruajtur rrjedhën logjike; • analizon dhe përdor nocione të reja në kontekste të ndryshme.	• merr pjesë në biseda të thjeshta, duke bërë pyetje dhe dhënë përgjigje; • transmeton saktë informacion në forma të ndryshme; • përshkruan ngjarje duke ruajtur rrjedhën logjike; • diskuton për një temë duke respektuar rregullat e komunikimit; • luan rol mbështetës në diskutime dhe ndihmon për të kontribuar.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> • ndjek dhe vlerëson organizimin logjik të argumenteve; • përdor mjete ndihmëse, përfshirë të dhëna statistikore dhe grafikë; • përdor mjetet dhe pajisjet teknologjike; • përdor të dhëna shkencore për të nxjerrë përfundime bazuar në prova; • regjistron informacionin në forma të ndryshme (tabela, grafike, narrative); • shfrytëzon burime të ndryshme për zhvillimin e ideve dhe projekteve;	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> • përdor dhe përpunon përmbajtje digjitale; • analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe marrë vendime të informuara; • identifikon dhe zgjidh probleme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; • menaxhon dhe mbron informacionin dhe identitetet digjitale; • bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve;

• parashtron pyetje dhe organizon mendimet për zgjidhjen e problemeve; • prezanton idetë për zhvillimin e aktiviteteve dhe argumenton ato; • paraqet argumente për problemet nga gjeografia; • përdor informacionin për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve duke argumentuar; • interpreton dukuri dhe procese me shembuj nga jeta e përditshme.	• përdor mendimin kritik gjatë shfrytëzimit të TIK-ut për zhvillimin e projekteve.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i> • identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale; • organizon dhe fokusohet në të nxënit, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij; • motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup; • shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive; • negocion dhe zgjidh konflikte në mënyrë konstruktive, menaxhon stresin; • analizon dhe zgjidh probleme emocionale dhe sociale, duke propozuar alternativa pozitive.	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> • tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë; • vlerëson diversitetin me tolerancë dhe respekt; • demonstroi vlerat e të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal dhe lufta kundër diskriminimit; • menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme; • demonstroi sjellje etike ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore;

	reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe diskuton pasojat e këtyre veprimeve.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - përdor imagjinatën për procese krijuese dhe novatore; - planifikon projekte dhe i zhvillon; - punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon; - vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit; - ndërmerr aktivitete për zgjidhjen e problemeve shoqërore (ekspozita, fushata etj.); - analizon pasojat e dëmtimit të mjedisit dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e tij.	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - shpreh dhe interpreton emocionet dhe idetë e tij me art dhe forma të tjera kulturore; - shpreh veten në media të ndryshme, duke përmirësuar kapacitetin personal; - angazhohet në procese krijuese, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjeografisë

Gjeografia krijon një lidhje të drejtpërdrejtë mes dijes shkollore dhe jetës reale, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë botën që i rrethon. Programi i saj luan një rol kyç në trajtimin e temave ndërkurrikulare, pasi nëpërmjet analizës së hapësirës, mjedisit dhe marrëdhënieve njerëzore, gjeografia krijon mundësi për të eksploruar çështje si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, migracioni, globalizimi dhe drejtësia mjedisore, duke i lidhur ato me situata konkrete dhe kontekste të përditshme. Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësi për të menduar në mënyrë kritike, për të bashkëpunuar, për të reflektuar mbi vlerat demokratike dhe për të vepruar me ndërgjegje dhe përgjegjësi në një botë dinamike dhe të ndërlidhur.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur, përshkruhet si gjeografia mundëson trajtimin e temave ndërkurrikulare:

a) Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

Gjeografia i pajis nxënësit me njohuri për vendin e tyre, për pasuritë natyrore, diversitetin dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si dhe për veçoritë e zhvillimit ekonomik e shoqëror, duke kontribuar në ndërtimin e vetëdijes kombëtare dhe forcimin e identitetit kombëtar. Përmes studimit të kulturave të ndryshme dhe mënyrave të jetesës në vende të ndryshme të botës, nxënësit zhvillojnë tolerancën dhe respektin për diversitetin kulturor.

b) Qytetaria aktive dhe sipërmarrja

Gjeografia luan një rol të rëndësishëm në formimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të angazhuar në jetën shoqërore dhe ekonomike; ajo nxit mendimin kritik, analizën e problemeve reale si dhe angazhimin aktiv të nxënësve për zgjidhjen e tyre. Përmes mësimit të gjeografisë, nxënësit eksplorojnë burimet natyrore, potencialin ekonomik të zonave të ndryshme, ndikimin e infrastrukturës në zhvillim. Kjo i ndihmon të identifikojnë mundësitë për zhvillim, ekonomik dhe shoqëror, duke mbështetur zhvillimin e sipërmarrjes.

c) Shëndeti mendor, fizik dhe siguria


Gjeografia u mundëson nxënësve të identifikojnë zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore, si tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut etj., dhe të kuptojnë pasojat që ato kanë mbi shëndetin dhe mirëqenien e komuniteteve. Ajo ndihmon në kuptimin e ndikimit të ndotjes mjedisore në shëndetin fizik dhe mendor të njerëzve. Përmes edukimit për hapësirën dhe mjedisin, nxënësit mësojnë sjellje të sigurt dhe të përgjegjshme në situata të ndryshme, si dhe aftësi për të parandaluar dhe përballuar emergjencat natyrore.

d) Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore

Kjo temë ndërkurrikulare përbën një nga shtyllat kryesore të gjeografisë, duke nxitur te nxënësit një kuptim të thelluar të ndërveprimit midis njeriut dhe natyrës. Përmes studimit të gjeografisë, nxënësit mësojnë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, ndikimin e aktivitetit njerëzor në ndryshimet klimatike dhe anasjelltas, pasojat e urbanizimit të pakontrolluar dhe nevojën për ruajtjen e ekuilibrave mjedisore; ata zhvillojnë aftësi për të analizuar probleme mjedisore në nivel lokal dhe global, dhe për të identifikuar zgjidhje praktike që promovojnë ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm. Gjeografia luan një rol kyç në edukimin për mënyra të qëndrueshme jetese, duke forcuar ndërgjegjësimin, përgjegjësinë dhe angazhimin qytetar ndaj sfidave mjedisore të kohës sonë.

e) Teknologjia, shoqëria dhe media

Në lëndën e gjeografisë, nxënësit mësojnë të përdorin harta digjitale, kërkojnë informacione online dhe mësojnë të kuptojnë të dhëna që lidhen me vende dhe mjedise të ndryshme. Ata zhvillojnë aftësi për të lexuar dhe analizuar informacione hapësinore, si edhe për të kuptuar se si vendndodhja ndikon në jetën e përditshme. Kjo i ndihmon nxënësit të përdorin teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme, të kuptojnë si merren vendime në bazë të informacionit dhe të përdorin median për të mësuar dhe për t'u informuar si pjesë e shoqërisë.



Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi për trajtimin e temave ndërkurrikulare:


- ***Të promovohen vlera dhe qëndrime përtej përvetësimit të njohurive.*** Temat ndërkurrikulare janë pjesë e qëllimeve të arsimit parauniversitar dhe duhet të integrohen në mënyrë të natyrshme në mësimdhënien e gjeografisë.
- ***Të planifikojë përfshirjen e këtyre temave në mënyrë funksionale, jo sipërfaqësore.*** Për shembull, kur trajtohet tema e klimës dhe ndryshimeve klimatike, mësuesi mund të integrojë konceptin e përgjegjësisë individuale dhe kolektive ndaj mbrojtjes së mjedisit. Kjo i ndihmon nxënësit të ndërtojnë vetëdije sociale dhe mjedisore.
- ***Të nxisë mendimin kritik dhe pjesëmarrjen aktive.*** Temat ndërkurrikulare janë një mundësi për të nxitur diskutime, reflektim, punë në grup dhe ndërgjegjësim qytetar. Mësuesi duhet të krijojë hapësirë për pyetje, qëndrime dhe propozime nga vetë nxënësit.
- ***Të përshtatë përmbajtjen me moshën dhe kontekstin e nxënësve.*** Përfshirja e temave të mëdha duhet bërë në mënyrë të kuptueshme dhe të lidhur me përvojën e përditshme të nxënësve, duke shmangur ndërlikimin e panevojshëm ose largësinë nga realiteti i tyre.

Në mënyrë më të detajuar shembuj të veprimtarive praktike për zhvillimin e temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Kompetencat e lëndës së gjeografisë dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat e lëndës së gjeografisë përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që nxënësit duhet të zhvillojnë për të kuptuar, analizuar dhe interpretuar mjedisin gjeografik, shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, si edhe marrëdhëniet komplekse ndërmjet natyrës dhe shoqërisë.

Kompetencat kryesore të lëndës së gjeografisë janë:



Këto kompetenca ndihmojnë nxënësin:

- të kuptojë botën përreth dhe ndërveprimet komplekse midis natyrës dhe shoqërisë;
- të mendojë në mënyrë kritike dhe të analizojnë çështje globale si ndryshimet klimatike, urbanizimi, migracioni etj.;
- të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në komunitet dhe në shoqëri.

Kompetencat e lëndës së gjeografisë ndërtohen në mënyrë të ndërlidhur me kompetencat kyçe dhe zhvillohen përmes:

- situatave reale të të nxënit;
- projekteve, vëzhgimeve dhe punës në terren;
- përdorimit të hartave dhe burimeve digjitale;
- zgjidhjes së problemeve konkrete.

Kompetencat e lëndës së gjeografisë zbërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Tabela 2: Kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat e lëndës së gjeografisë që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e gjashtë
---	---------------------------	---

**VËZHIMI DHE
HETIMI I
DUKURIVE
GJEOGRAFIKE**

Kompetenca "Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike" i referohet aftësisë së nxënësve për të vëzhguar, eksploruar dhe analizuar në mënyrë sistematike dukuritë natyrore dhe shoqërore që ndodhin në hapësirën gjeografike. Kjo kompetencë përbën themelin e kërimit gjeografik dhe i përgatit nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësitë vëzhguese. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj kompetence, nxënësit aftësohen të përdorin mjetet gjeografike si hartat, busullën dhe teknologjinë për të hetuar dhe kuptuar ndryshimet që ndodhin në mjedisin gjeografik. Ata fillojnë të kuptojnë se dukuritë gjeografike nuk janë të izoluara, por ndër lidhen dhe ndikojnë njëra-tjetrën në hapësirë dhe kohë.

Nxënësi:

- formulon pyetje kërkimore të thjeshta për një çështje gjeografike;
- shpreh ide dhe hipoteza fillestare, duke spekuluar mbi përgjigjet e mundshme për çështje që lidhen me mjedisin lokal;
- vëzhgon dhe analizon në mjedisin lokal veçoritë natyrore, veçoritë e popullsisë, të ekonomisë, të vendbanimeve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, dhe ndërveprimin midis tyre;
- zbulon dhe shpjegon marrëdhënie shkak-pasojë midis dukurive natyrore (si p.sh., reshjet dhe përmbytjet, thatësira dhe mungesa e bimësisë etj.), ndikimeve që ato kanë në jetën e përditshme të njerëzve, dhe anasjelltas;
- përdor mjedisin lokal si kontekst studimi për të vëzhguar dhe analizuar çështje mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike, si erozioni, ndotja, përdorimi i burimeve natyrore etj.;

		dokumenton vëzhgimet përmes përshkrimeve të thjeshta, vizatimeve, fotografive ose skemave.
MBLEDHJA, PËRPUNIMI DHE KOMUNIKIMI I INFORMACIONIT GJEORAFIK	Kompetenca "Mbledhja, përpunimi dhe komunikimi i informacionit gjeografik" i referohet aftësisë për të mbledhur, përzgjedhur, vlerësuar dhe paraqitur informacion gjeografik nga burime të ndryshme. Kjo kompetencë i ndihmon nxënësit të bëhen kërkues aktivë të informacionit, duke zhvilluar aftësinë për të dalluar burimet e besueshme dhe për të analizuar në mënyrë kritike të dhënat gjeografike. Kompetenca përfshin aftësinë për të komunikuar informacionin gjeografik në mënyra të ndryshme: me gojë, me shkrim, përmes hartave, grafikëve, tabelave apo formave digjitale. Nxënësit mësojnë të transformojnë informacionin e mbledhur në njohuri të strukturuar, si dhe të përdorin terminologjinë e përshtatshme gjeografike gjatë komunikimit.	<i>Nxënësi:</i> - identifikon dhe shqyrton burime informacioni të ndryshme (tekste, grafikë, harta, fotografi, burime digjitale); - vlerëson besueshmërinë dhe rëndësinë e burimeve të informacionit në varësi të qëllimit të kërkimit; - përdor mjete gjeografike (harta, vëzhgime në terren, imazhe satelitore, foto etj.), përfshirë ato digjitale, për të ndërtuar njohuri rreth mjedisit lokal; - përshkruan shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme; - komunikon në mënyra të ndryshme (me gojë, me shkrim, vizualisht ose grafikisht), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm të gjeografisë për të përshkruar vendndodhjen, tiparet dhe ndërveprimet në hapësirë.

MARRJA E VENDIMEVE MBI BAZËN E INFORMACIONIT GJEORAFIK	Kompetenca "Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit gjeografik" i referohet aftësisë për të analizuar situata që lidhen me hapësirën gjeografike dhe për të marrë vendime të arsyeshme bazuar në informacionin e mbledhur dhe analizuar. Nxënësit zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësitë analitike duke identifikuar probleme të thjeshta mjedisore dhe shoqërore në komunitetin e tyre dhe më gjerë. Kjo kompetencë i përgatit nxënësit të bëhen qytetarë të përgjegjshëm që mund të marrin vendime të informuara për çështje që lidhen me mjedisin dhe komunitetin e tyre. Ata fillojnë të kuptojnë se si vendimet dhe sjelljet individuale dhe kolektive ndikojnë në mjedisin lokal dhe global.	<i>Nxënësi:</i> • sintetizon informacionin e mbledhur nga burime të ndryshme dhe arrin në përfundime të thjeshta rreth një dukurie gjeografike, problemi mjedisor (p.sh., ndotja e tokës në mjedisin lokal); • zhvillon parashikime të thjeshta mbi ndikimet që një dukuri apo veprim mund të ketë në një hapësirë të caktuar (p.sh., çfarë ndodh nëse ndërtohet në zona të rrezikuara nga përmbytjet); • identifikon zgjidhje alternative për një problem lokal (si p.sh., ndotja, mungesa e gjelbërimit) dhe parashikon pasojat e secilës prej tyre; • përdor pyetje reflektuese gjatë zgjidhjes së një problemi: “Çfarë funksionoi?”, “Çfarë nuk shkoi?”, “Si mund të përmirësohet?”, duke ndërtuar kështu vetëvlerësimin dhe të menduarin kritik; • merr vendime të arsyetuara, të cilat bazohen në analizën e informacionit dhe në kuptimin e pasojave që kanë për mjedisin dhe komunitetin.
--	---	--

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë/nëntematikë për klasën e gjashtë

Programi i gjeografisë për klasën e 6-të zhvillohet në 35 orë mësimore (1 orë mësimore/javë x 35 javë). Programi specifikon orët e sugjeruara për tematikë dhe nëntematikat. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat, projektin kurrikular, vëzhgimet në natyrë, testimet. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën nëntematikë.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për tematikë dhe nëntematikat

Tematika	Ndërrvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve			Orë mësimore vjetore në total
Nën tematikat	<i>Gjeografia dhe kërkimi gjeografik</i>	<i>Hartat gjeografike</i>	<i>Mjedisi ynë lokal</i>	
Orë mësimore	8	12	15	35

5.2 Përmbajtja e klasës së gjashtë

Në programin e gjeografisë për klasën e gjashtë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërrvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve, mjediseve” dhe nën tematikat: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik; Hartat gjeografike; Mjedisi ynë lokal. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Për secilën nën tematikë janë paraqitur njohuritë dhe aftësitë që duhet të demonstrojë nxënësi, ndërkohë që qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndën e gjeografisë janë të përbashkëta për të gjitha nën tematikat.

Kombinimi dhe ndarja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

TEMATIKA: Ndërrvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve

Përshkrimi i tematikës:

Në klasën e VI- të, tematika “Ndërrvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve” ofron një bazë thelbësore për njohuritë gjeografike të nxënësve. Nxënësit njihen me konceptet bazë të gjeografisë si shkencë dhe mënyrat se si kryhet kërkimi gjeografik, duke përfshirë metodat e vëzhgimit, mbledhjes dhe interpretimit të të dhënave. Ata mësojnë të punojnë me harta të ndryshme gjeografike dhe mjete të tjera gjeografike. Nën tematika e mjedisit lokal i ndihmon nxënësit të eksplorojnë mjedisin rreth tyre, të vëzhgojnë dhe analizojnë veçoritë e relievit, të klimës, të hidrografisë, të florës dhe faunës së zonës, të popullsisë, të ekonomisë, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe të zhvillojnë ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto njohuri formojnë bazën për studime më të thelluara gjeografike në vitet në vazhdim dhe ndihmojnë në formimin e aftësive praktike për të kuptuar dhe interpretuar botën përreth.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë	Aftësitë
Gjeografia dhe kërkimi gjeografik	
- Gjeografia dhe konceptet bazë të kërkimit gjeografik: vendndodhja/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi dhe zhvillimi. - Kërkimi gjeografik: metodat dhe mjetet gjeografike që përdoren për të realizuar kërkimin gjeografik. - Gjeografi dhe roli i tij në studimin e dukurive gjeografike.	Nxënësi: - demonstron përmes shembujve kuptim të koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: - vendndodhja/ vendi, - mjedisi, - rajoni, - ndërveprimi, - zhvillimi. - përshkruan metodat shkencore të kërkimit gjeografik: - përdorimi i burimeve parësore dhe dytësore; - analiza dhe interpretimi i të dhënave. - diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë; - diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.
Hartat gjeografike	

Mjedisi ynë lokal

• Tiparet kryesore të mjedisit natyror të zonës (qytetit/fshatit) së banimit • Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror të zonës • Popullsia, shtimi natyror, struktura e popullsisë, lëvizjet e saj dhe faktorët që ndikojnë dhe kanë ndikuar në këto lëvizje	Nxënësi: • interpreton në hartë vendndodhjen e zonës (qytetit/fshatit) ku banon; • përshkruan: - përbërësit kryesorë të relievit duke dalluar elementë të veçantë; - pasuritë ujore (burime, lumenj, liqene, dete etj.) të zonës ku banon; - botën bimore dhe shtazore; - klimën në mjedisin ku jeton. • demonstroi orientimin në terren duke përdorur elementet natyrore, si p.sh., Diellin, myshqet në pemë, rrathët e drurëve të pemëve etj., për të përcaktuar drejtimet kryesore të horizontit në mjedisin lokal; • vëzhgon dhe sjell shembuj si kanë ndikuar kushtet natyrore në jetën e banorëve; • diskuton mbi rrugët nëpërmjet të cilave njerëzit kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore (p.sh., përdorimi i gurëve, rërës, ndërtimi i hidrocentraleve etj.); • përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton, duke dalluar grup moshat që dominojnë; • mbledh të dhëna statistikore për të shpjeguar lëvizjet e popullsisë së zonës në periudha të ndryshme dhe shkaqet;
--	--

• Vendbanimet dhe mënyra e jetesës së njerëzve në mjedisin lokal • Trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit lokal dhe mbrojtja e saj • Aktivitetet prodhuese dhe organet e qeverisjes lokale e qendrore të mjedisit që na rrethon	• dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij dhe si ato janë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si p.sh., faktorët klimatikë, urbanizimi, zhvillimi industrial etj.; • krahason mënyrën e jetesës së popullsisë në mjedisin e tij lokal me atë të popullsisë në mjedise të tjerë; • evidenton: - monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës; - vlerat turistike që kanë monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës; - rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës; • diskuton mbi rrugët e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonës në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore; • kërkon dhe përdor materiale digjitale (p.sh., foto, video nga interneti ose të realizuara vetë) që tregojnë si veprimet e njerëzve ndikojnë në natyrë, duke interpretuar ndryshimet e vërejtura dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit; • identifikon llojet kryesore të veprimtarive prodhuese ekonomike, industriale dhe tregtare në mjedisin lokal;
--	---

Zhvillimi mjedisor dhe bashkëveprimi komunitar për mbrojtjen e tij	- përcakton vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore, objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.; - parashtron ide mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut në mjedisin natyror të zonës dhe nevojën e bashkëpunimit komunitet – qeverisje lokale për mbrojtjen e mjedisit; - përdor hartën topografike të qytetit/fshatit për t'u orientuar në mjedisin e tij lokal; - krijon një prezantim të thjeshtë (p.sh., me PowerPoint ose aplikacione të tjera) për të treguar ndikimin e ndryshimeve klimatike ose të problemeve mjedisore (p.sh., ndotja) në qytetin/fshatin e tij.
Qëndrimet/vlerat Nxënësi: - shfaq interes dhe motivim për të mësuar rreth gjeografisë, degëve të saj dhe mundësive të karrierës që lidhen me lëndën; - komunikon lirshëm dhe me siguri mendimet, idetë dhe interpretimet personale gjatë veprimtarive, duke përdorur gjuhë të përshtatshme për moshën dhe temën; - respekton kontributin individual dhe të grupit, duke bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe duke treguar gatishmëri për të dëgjuar dhe për të dhënë ndihmë; - demonstron kuriozitet dhe vëmendje ndaj mjedisit natyror të zonës ku jeton dhe më gjerë, duke shprehur dëshirë për të kuptuar dhe ruajtur peizazhin, klimën, florën dhe faunën;	

- tregon interes për të eksploruar dhe analizuar harta të ndryshme tematike (si harta fizike, administrative, klimatike, ekonomike etj.), duke zhvilluar aftësi për orientim dhe interpretim hapësinor;
- shpërndan me të tjerët përvojat dhe informacionin që ka përfituar nga vëzhgimet personale, udhëtimet, puna në grup apo kërkimet në terren dhe online;
- respekton dhe vlerëson pikëpamjet, përvojat dhe informacionin që ndajnë shokët e klasës apo burime të tjera, duke treguar ndjeshmëri ndaj të ndryshmes;
- pranon dhe respekton diversitetin natyror, kulturor dhe shoqëror të zonës së tij/saj, të rajoneve të ndryshme dhe të vendeve të tjera, duke ndërtuar ndjeshmëri ndërkulturore dhe ndjenjë përkatësie;
- tregon përkujdesje dhe ndjeshmëri ndaj mjedisit, duke marrë pjesë në veprime konkrete për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve natyrore si uji, ajri, toka dhe biodiversiteti;
- vlerëson në mënyrë objektive rezultatet e vëzhgimeve apo kërkimeve të veta dhe i krahason ato me rezultatet e shokëve, duke pranuar kritikën pozitive dhe duke mësuar prej tyre;
- shfaq mendim të pavarur dhe krijues, duke paraqitur zgjidhje të ndryshme për një problem gjeografik dhe duke arsyetuar zgjedhjet e veta;
- vetë vlerëson dhe reflekton mbi të nxënit, duke përdorur mendimin kritik për të kuptuar çfarë ka mësuar, dhe si mund të përmirësojë përqasjen e tij ndaj të nxënit dhe punës;
- zbaton me përgjegjësi rregullat e sigurisë digjitale, sidomos gjatë përdorimit të teknologjisë së informacionit në kërkime gjeografike, duke shmangur faqet e pasigurta, mbrojtur të dhënat personale dhe duke kërkuar ndihmë në rast nevojë.

5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi në përmbushje të rezultateve të të nxënit (RN-ve) në nën tematika të ndryshme.

Tabela 4. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

Rezultatet e të nxënit	Shembuj të veprimtarive mësimore praktike
- Nxënësi përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike. - Nxënësi përshkruan një itinerar në hartë kur janë dhënë drejtimet kryesore të lëvizjes dhe objekte gjeografike të dallueshme.	Veprimtaria: Udhëtim virtual nëpër Shqipëri (eksplorimi me koordinata gjeografike) - Nxënësit do të përcaktojnë dhe përdorin koordinatat gjeografike për të hartuar një itinerar udhëtimi dhe do të realizojnë një “udhëtim virtual” nga një qytet në një tjetër, duke eksploruar rrugën, largësitë dhe veçoritë gjeografike të zonave të përshkuara. - Mësuesi përgatit një listë me destinacione të ndryshme (p.sh., Tiranë, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër, Tropojë etj.). - Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grup merr një hartë dhe një listë itinerari të destinacioneve. Çdo grup do të përcaktojë koordinatat dhe drejtimin që do të ndjekë se si mund të udhëtojnë nga një qytet në tjetrin, duke përdorur të dhënat përkatëse të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike.

	- Nxënësit duhet të shënojnë në hartë rrugën që mund të ndjekin dhe të diskutojnë në grup rreth karakteristikave të ndryshme gjeografike që mund të ndikojnë në udhëtim, si p.sh., relievi, klima etj.
- Nxënësi dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij dhe si ato janë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si p.sh., faktorët klimatikë, urbanizimi, zhvillimi industrial etj.	Veprimtaria: Vendbanimet dhe traditat • Mësuesi nis veprimtarinë duke u drejtuar nxënësve disa pyetje për të hapur bisedën: - Si është qyteti/fshati ku jetoni? - A ka ndryshuar shumë nga koha kur ishin prindërit tuaj të vegjël? - Cilat janë disa tradita që njihni nga zona juaj (veshje, ushqime, festa, ndërtimet e shtëpive)? Shfaqen foto të zonës, nga e kaluara dhe aktuale (nëse është e mundur). • Nxënësit ndahen në grupe të vogla (3–4 nxënës). Çdo grup merr disa pyetje të thjeshta për t'i diskutuar dhe për të përgatitur përgjigjet: - Cilat ndërtesa të reja janë ndërtuar në zonën tuaj? - A ka ndikuar ndërtimi i rrugëve apo fabrikave në jetën e përditshme? - Si mund të ruajmë traditat edhe kur qyteti/fshati zhvillohet? - A ka ndodhur ndonjë përmbytje apo thatësi në zonën ku jetoni?

	- Si kanë ndikuar këto në jetën e njerëzve? - A janë ndërtuar shtëpi në vende të pasigurta që ndikohen nga pasojat e ndryshimeve të klimës, si p.sh., afër lumenjve? - Çfarë mund të bëjmë për ta mbrojtur mjedisin dhe për të ruajtur vendin ku jetojmë? • Çdo grup ndan 2–3 ide nga diskutimi i vet me klasën. Mësuesi i ndihmon nxënësit të dallojnë faktorët që ndikojnë në vendbanime (p.sh., urbanizimi, ndërtimet, zhvillimi ekonomik, ndryshimet klimatike) dhe traditat që duhen ruajtur. • Nxënësit plotësojnë një fletë të shkurtër reflektimi: “Çfarë më pëlqen më shumë në vendin ku jetoj?” “Cila traditë do të doja të ruhej edhe kur zona të zhvillohet më shumë?”
--	--

Më poshtë janë përshkruar disa shembuj veprimtarish¹ për nën tematika të ndryshme:

¹ Shembujt e veprimtarive nuk janë detyrues për mësuesin dhe përdoruesit e tjerë të programit. Mësuesi është i lirë të përzgjedhë të zhvillojë me nxënësit nga këto veprimtari ose veprimtari të tjera, në përshtatje dhe me kontekstin e klasës.

a) Nëntematika “Gjeografia dhe kërkimi gjeografik”

- ***Veprimtaria: Loja “Gjeografi i ri në terren”***

Nxënësit mund të luajnë rolin e një gjeografi. Ata bëjnë një vëzhgim të thjeshtë në zonën përreth, marrin fotografi, mbajnë shënime për peizazhin, për aktivitetet njerëzore etj., analizojnë të dhënat e mbledhura dhe i paraqesin në një fletë pune si burime parësore; më pas i krahasojnë me të dhëna nga interneti, libra ose harta (burime dytësore) dhe prezantojnë në klasë “raportin e gjeografit”. Kjo veprimtari mund të zhvillohet dhe në formën e një loje me role “Bisedë me një gjeograf”, ku nxënësit që vihen në rolin e gjeografit mund të dialogojnë me nxënësit që vihen në rolin e gazetarit.

- ***Veprimtaria: Udhëtim në kohë “Linja e kohës”***

Nxënësit krijojnë një kronologji të shkurtër me 4–5 ngjarje të rëndësishme në zhvillimin e gjeografisë, si p.sh., hartat e para nga grekët e lashtë, zbulimet gjeografike (shek. XV-XVI), lindja e gjeografisë moderne, përdorimi i teknologjisë në gjeografi (harta digjitale, satelitë), të cilën mund ta shprehin në formën e një linje kohe horizontale/vertikale ku për secilën ngjarje përfshijnë emërtimin e ngjarjes, vitin ose shekullin e përafërt, përshkrimin shkurt të rëndësisë së saj.

b) Nëntematika “Hartat gjeografike”

- ***Veprimtaria: Planifikuesi i udhëtimit***

Nxënësit mund të planifikojnë një udhëtim imagjinar duke shfrytëzuar informacionin që përftojnë përmes përdorimit të hartave; ata përzgjedhin llojin e hartës më të përshtatshme për të planifikuar secilën fazë të udhëtimit: hartën administrative për të gjetur rajonin, hartën meteorologjike për të përgatitur rrobat, hartën e hidrografisë për të gjetur zonat me burime ujore etj.

- ***Veprimtaria: Gara e largësive***

Mësuesi mund të organizojë një konkurs me nxënësit për përlllogaritjen e largësive mes qyteteve të ndryshme në Shqipëri duke përdorur shkallën e hartës. Fituesi është ai që afrohet më shumë me largësinë e saktë.

- ***Veprimtaria: Gjuetia e “thesarit gjeografik”***

Mësuesi mund të japë koordinatat gjeografike dhe nxënësit të gjejnë se çfarë gjendet në atë pikë në hartë. “Thesari” mund të jetë p.sh., një qytet, mal apo vend interesant, të cilin nxënësit e përshkruajnë.

- ***Veprimtaria: Loja e orientimit***

Mësuesi mund të organizojë një veprimtari praktike në oborrin e shkollës ku nxënësit ndjekin udhëzime për drejtimet e lëvizjes me objekte referuese, për të arritur në destinacion.

c) Nën tematika “Mjedisi ynë lokal”

- ***Veprimtaria: “Ekspedita” e orientimit në natyrë***

Mësuesi mund të organizojë një ekskursion në natyrë (në oborrin e shkollës ose në një park në afërsi të shkollës) ku nxënësit mësojnë të përdorin shenjat natyrore për orientim, si p.sh., pozicioni i Diellit në orë të ndryshme, myshqet në pemë, rrathët e drurëve etj., apo të përdorin busullën. Nxënësit mund të krijojnë "udhëzuesin e orientimit" me foto dhe përshkrime.

- ***Veprimtaria: “Meteorologu lokal” në gjurmët e ndryshimeve klimatike***

Nxënësit mbajnë një ditar moti për një periudhë njëmuajore, duke regjistruar temperatura ditore, sasinë e reshjeve dhe dukuri të tjera atmosferike. Më pas, ata i krahasojnë këto të dhëna me mesataret historike të rajonit, për të identifikuar devijime ose prirje të pazakonta që mund të lidhen me ndryshimet klimatike. Në vijim, nxënësit analizojnë ndikimin e këtyre ndryshimeve në jetën e përditshme të komunitetit (në bujqësi, shëndet, energji etj.) dhe propozojnë masa konkrete që shkolla dhe komuniteti mund të ndërmarrin për të kontribuar në përballimin e sfidave klimatike, si gjelbërimi i hapësirave, kursimi i energjisë etj.

- ***Veprimtaria: Urbanisti i vogël***

Nxënësit analizojnë se si janë ndërtuar shtëpitë dhe lagjet duke marrë parasysh klimën, relievin dhe faktorë të tjerë; analizojnë se cilat dhoma në shtëpitë e tyre janë më të ngrohta/ftohta, duke e lidhur me orientimin e tyre ndaj Diellit. Dhomat e orientuara nga jugu janë më

të ngrohta, pasi marrin më shumë diell, ndërsa ato të orientuara nga veriu janë më të ftohta, pasi marrin më pak diell. Nxënësit skicojnë një plan për një lagje "ideale" për zonën e tyre.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen në mënyrë të detajuar veprimtari për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve sipas tematikave dhe nën tematikave të lëndës.

6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies në lëndën e gjeografisë janë thelbësore për krijimin e një mjedisi mësimor efikas që nxit zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Metodologjia e mësimdhënies së gjeografisë në klasën e VI- të kërkon një qasje të gjithanshme që kombinon metoda të ndryshme didaktike për të zhvilluar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësve.

Në këtë moshë, nxënësit janë në fazën e zhvillimit të mendimit konkret drejt atij abstrakt, prandaj mësimi duhet të nisë nga përvoja e drejtpërdrejtë dhe të konkretizojë konceptet abstrakte përmes shembujve praktikë. Integrimi i teknologjisë dhe mjeteve vizuale është thelbësor për ta bërë mësimin më tërheqës dhe të kuptueshëm.

Disa ndër metodat dhe teknikat kryesore të mësimdhënies së gjeografisë në këtë klasë përfshijnë:

Vëzhgimet dhe eksplorimi përdoren gjerësisht për të mësuar nxënësit të vëzhgojnë dukuritë gjeografike në mjedisin e tyre të afërt. Teknikat e kësaj metode përfshijnë vëzhgimet në terren (nëse është e mundur) ku nxënësit mund të vëzhgojnë p.sh., burimet ujore, llojet e vegjetacionit, ndikimet e aktivitetit njerëzor në peizazh etj.; studimi i hartave lokale mundëson identifikimin e elementeve gjeografike të zonës së tyre, ndërsa analiza e fotografive ajrore dhe satelitore i ndihmon të kuptojnë ndryshimet në kohë të peizazhit. Vrojtimi i motit dhe regjistrimi i të dhënave klimatike gjatë periudhave të ndryshme i mëson të kuptojnë ndryshueshmërinë e klimës.

Demonstrimi dhe modelimi - Përdorimi i këtyre metodave realizohet përmes modeleve dhe eksperimenteve të thjeshta që e bëjnë mësimin më ndërveprues dhe më të lehtë për t'u përvetësuar. Krijimi i modeleve të relievit me argjilë, plastelinë ose materiale të ricikluara ndihmon në kuptimin tredimensional të formave të tokës. Simulimi i proceseve të erozionit përmes eksperimenteve me ujë dhe rërë demonstroi ndikimin e forcave natyrore. Demonstrimet me busulla dhe harta zhvillojnë aftësitë bazë të orientimit.

Lojërat didaktike dhe simulimi janë një nga metodat më efektive për mësimdhënien e gjeografisë, duke krijuar një eksperiencë mësimore që është njëkohësisht argëtuese, sfiduese dhe edukative. Përdorimi i lojërave gjeografike si kuize interaktive, lojërat me hartat, loja në role ku nxënësit për shembull interpretojnë banorë të mjedisit lokal, simulimi i situatave si plani i evakuimit në rast fatkeqësish natyrore apo organizimi i një guide turistike virtuale u zhvillojnë nxënësve një tërësi aftësish të tilla, si të menduarit kritik e krijues, të menduarit hapësinor, aftësi sociale dhe komunikuese, aftësi personale, aftësi motorike, aftësi digjitale etj. Konkurrimi midis grupeve p.sh., për identifikimin e vendeve në hartë apo gjetjen e thesarit gjeografik, nxit pjesëmarrjen aktive.

Teknika e tregimit - Në këtë grup moshë, tregimi përshtatet më së miri me nevojën e nxënësve për të kuptuar botën përmes përvojave personale dhe lidhjeve emocionale. Nxënësit janë ende të hapur ndaj magjisë së tregimeve por në të njëjtën kohë mund të kuptojnë informacione më komplekse të fshehura në tekste të ndryshme. Dëshira e tyre për aventurë dhe zbulim stimulohet përmes historive të eksplorimeve, ndërsa zhvillimi i identitetit të tyre kulturor përforcohet përmes krahasimit me kultura të tjera. Tregimi i historive të udhëtarëve të famshëm si p.sh., Marko Polo etj., nxit interesin për vendet e largëta.

Zgjidhja e problemeve – Përdorimi i metodës së zgjidhjes së problemeve përfshin paraqitjen para nxënësve të situatave reale apo hipotetike që kërkojnë analizë, mendim kritik dhe gjetjen e zgjidhjeve praktike. Kjo metodë transformon nxënësit nga marrës pasivë të informacionit në zgjidhës aktivë të problemeve, duke i përballur me sfida të ngjashme me ato që hasin gjeografët në jetën reale.

Përmes gjetjes së zgjidhjeve për sfidat praktike si p.sh., “A duhet të ndërtohet një fabrikë në një zonë turistike”, “Çfarë masash do të merrnit për të mbrojtur bregdetin nga erozioni?” etj., nxënësit zhvillojnë kuptim të thellë të koncepteve gjeografike, zhvillojnë të menduarit sistematik për lidhjen midis elementeve të ndryshëm duke kuptuar se si ndryshimi i një faktori ndikon në të gjithë sistemin, zhvillojnë aftësinë për të parashikuar rezultatet e veprimeve të ndryshme, sikurse zhvillojnë aftësi sociale të pranimit të këndvështrimeve të ndryshme, të empatisë, të përgjegjshmërisë qytetare, aftësi të komunikimit e prezantimit të informacionit etj.

Puna në grup - Puna në grup përfaqëson një nga metodat më efektive dhe gjithëpërfshirëse në mësimdhënien moderne të gjeografisë. Kjo qasje transformon klasën nga një mjedis ku mësuesi jep informacione dhe nxënësit i marrin pasivisht, në një laborator aktiv ku nxënësit bëhen kërkues, krijues dhe prezantues të njohurive të tyre gjeografike. Përmes organizimit në grupe të vogla nxënësit mësojnë të ndajnë ide dhe të respektojnë mendimet e të tjerëve; nëpërmjet diskutimit dhe analizës së përbashkët, kuptojnë më mirë konceptet gjeografike; nxënësit analizojnë të dhëna, hartojnë përfundime dhe ofrojnë zgjidhje për probleme reale. Puna në grup krijon një atmosferë më dinamike dhe më tërheqëse për të mësuar.

Puna individuale në gjeografi është një metodë mësimore ku nxënësi punon i vetëm për të hulumtuar, analizuar dhe përpunuar njohuritë gjeografike. Ajo ndihmon në zhvillimin e mendimit kritik, vetë-mësimit dhe aftësive kërkimore. Nxënësi përdor burime të ndryshme si harta, tekste, të dhëna statistikore për të përgatitur ese, projekte ose detyra me karakter analitik apo përshkruar mbi dukuri natyrore, sociale ose ekonomike.

Metodat e përmendura më sipër nuk janë të vetmet dhe nuk përbëjnë një listë shteruese. Mësuesi ka lirinë dhe përgjegjësinë të zgjedhë ato metoda dhe teknika mësimore që i përshtaten më së miri rezultateve të temës mësimore, nevojave të nxënësve dhe kontekstit të orës mësimore. Metoda nuk është qëllim në vetvete, por një mjet në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësit. Prandaj, përdorimi i çdo metode duhet të jetë i menduar dhe i qëllimshëm, duke pasur në qendër përmirësimin e të kuptuarit, përfshirjes aktive dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes.

Qëllimi është krijimi i një eksperience mësimore që stimulon kuriozitetin, zhvillon aftësitë analitike dhe formon një marrëdhënie pozitive me mjedisin gjeografik. Organizimi i debateve mbi çështje gjeografike si p.sh., ndryshimet klimatike; kërkimet e vogla në terren si p.sh., matja e temperaturës në vende të ndryshme të oborrit të shkollës; intervistat me të rriturit për ndryshimet e vëzhguara në mjedis gjatë viteve; krijimi i ditarëve të motit dhe vëzhgimi i ndryshimeve sezonale etj., nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve.

6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë

Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë është shumë i rëndësishëm, pasi ato mundësojnë që nxënësit të lidhen me dukuritë dhe përvojat që ndodhin përreth tyre. Ky lloj mësimi e bën gjeografinë më të kuptueshme dhe më të zbatueshme në jetën e përditshme. Përdorimi i situatave reale i mundëson nxënësve të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike, dhe gjithashtu ndihmon që ata të zhvillojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me botën që i rrethon.

Përdorimi i situatave të të nxënit:

- *Përmirëson kuptimin e koncepteve të gjeografisë.* Situatat praktike ndihmojnë që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet gjeografike duke i lidhur me përvojën konkrete.
- *Siguron lidhjen me jetën e përditshme.* Mësimi i gjeografisë që lidhet me situata praktike mund të ndihmojë nxënësit të kuptojnë ndikimin e dukurive gjeografike në jetën e përditshme, si për shembull, ndikimi i klimës në bujqësi ose në mundësitë e zhvillimit të turizmit në zona të caktuara.
- *Nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe kritike.* Situatat praktike ofrojnë mundësi për nxënësit që të analizojnë dhe të japin zgjidhje për probleme gjeografike që i hasin në jetën reale. Kjo mund të jetë ndihmuese në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve.
- *Ndihmon në zhvillimin e të menduarit krijues.* Kur nxënësit angazhohen me situata reale, ata mund të shohin mundësi të reja dhe krijuese për t'i adresuar këto sfida gjeografike.

Shembull i një situate të nxëni:

Një shembull praktik mund të jetë mësimi për ndikimin e ndryshimeve klimatike në zhvillimin e bujqësisë së mjedisit lokal. Nxënësit mund të studiojnë të dhënat për ndryshimet e temperaturave dhe reshjeve në zonën ku banojnë dhe mund të shqyrtojnë sesi këto ndryshime mund të ndikojnë në kulturat bujqësore. Ata mund të shikojnë raste reale, si p.sh. dëmet që ndodhin në bujqësi për shkak të thatësirave, përmbytjeve ose ngricave të papritura. Pas këtij studimi, nxënësit mund të hartojnë propozime për mënyrat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjeografisë

Projektet kurrikulare në lëndën e gjeografisë ofrojnë mundësi që nxënësit të angazhohen në mënyrë aktive me mësimin dhe të zbatojnë njohuritë e fituara përmes aktiviteteve praktike dhe krijuese. Projektet kurrikulare janë një mjet efikas për të zhvilluar aftësitë analitike, kritike dhe krijuese të nxënësve, për të forcuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës dhe për të mundësuar integrimin ndër lëndor dhe me temat kroskurrikulare. Disa ndër aspektet kyçe të rolit të projekteve kurrikulare në mësimin e gjeografisë janë:

- Projektet kurrikulare i mundësojnë nxënësve **të kuptojnë dhe zbatojnë konceptet** e mësuara në lëndën e gjeografisë, **duke i lidhur ato me situata reale.**
- Nëpërmjet projekteve kurrikulare, nxënësit zhvillojnë **aftësi hulumtuese dhe analitike.** Ata mësojnë të mbledhin të dhëna, të analizojnë informacionin dhe të formulojnë përfundime të mbështetura nga të dhëna. Për shembull, një projekt mbi "rrezikun e përmbytjeve në një zonë të caktuar" mund të kërkojë që nxënësit të mbledhin të dhëna nga burime të ndryshme (raporte meteorologjike, studime të mëparshme etj.) dhe të analizojnë mundësitë e përmbytjeve në atë rajon.

-

- Projekti kurrikular shpesh zhvillohet në grup, gjë që **nxit bashkëpunimin dhe zhvillon aftësitë sociale** të nxënësve. Ata mësojnë të punojnë së bashku, të diskutojnë idetë e tyre dhe të arrijnë konsensus për zgjidhje të ndryshme. Bashkëpunimi i grupit është një mundësi për nxënësit të ndajnë njohuritë dhe të krijojnë zgjidhje të përbashkëta për çështje komplekse.
- Projekti kurrikular mund të **ofrojë mundësi për mësim të diferencuar**, ku nxënësit mund të angazhohen në mënyra të ndryshme, sipas interesave dhe aftësive të tyre. Disa mund të fokusohen më shumë në mbledhjen e të dhënave dhe analizën statistikore, ndërsa të tjerë mund të angazhohen më shumë në krijimin e një prezantimi vizual për të komunikuar rezultatet e projektit.
- Projektet kurrikulare janë një mundësi që nxënësit të zhvillojnë aftësi për **zgjidhjen e problemeve**, pasi shpesh ata do të përballen me çështje dhe situata reale që kërkojnë zgjidhje të mundshme. Kjo mbështet nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues, duke i ndihmuar ata të mendojnë për zgjidhje praktike për probleme gjeografike.
- Përmes projekteve, nxënësit **nxisin krijimtarinë dhe mund të zbatojnë ide të reja dhe inovative** për të adresuar çështje gjeografike. Ata mund të krijojnë harta, prezantime vizuale, ose modele të ndryshme që përfaqësojnë të dhëna gjeografike, duke përdorur mjete dhe teknologji të ndryshme për të ilustruar dhe shpjeguar idetë e tyre.
- Përmes projekteve kurrikulare, nxënësit mund të **përdorin teknologjinë** për të mbledhur, analizuar dhe paraqitur informacionin gjeografik. Përdorimi i hartave interaktive ose aplikacioneve për analizimin e të dhënave mund të jetë një mjet i shkëlqyer për t'i përgatitur ata për përdorimin e teknologjisë në studimet dhe karrierat e ardhshme.
- Projekte kurrikulare **rrisin motivimin dhe angazhimin e nxënësve**, pasi ato krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata reale. Nxënësit mund të ndjehen më të lidhur me lëndën e gjeografisë kur ata shohin se çfarë mund të bëjnë me njohuritë që kanë fituar. Angazhimi në projekte konkrete ndihmon që procesi i të mësuarit të jetë më i gëzueshëm dhe interesant.

Shembull projekti: Dokumentari i zonës sime

Nxënësit kombinojnë të gjitha gjetjet e tyre në një prezantim multimedial (PowerPoint, video etj.) që tregon historinë e plotë të zonës së tyre dhe sfidat për të ardhmen. Produkti mund të përfshijë harta, intervista, foto, statistika dhe propozime konkrete. Këto veprimtari ndihmojnë nxënësit të bëhen "ekspertë" të mjedisit të tyre lokal dhe të zhvillojnë një lidhje të thellë me komunitetin ku jetojnë.

6.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë

Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë kërkon një qasje fleksibël dhe të personalizuar. Përdorimi i metodave të diferencuara, i teknologjisë dhe veprimtarive të përshtatura është i nevojshëm për të siguruar që nxënësit të kenë mundësinë të zhvillohen dhe të përfshihen në mësimin e gjeografisë. Mbështetja e vazhdueshme, bashkëpunimi me prindërit dhe krijimi i një mjedisi mbështetës janë gjithashtu faktorë kyç për suksesin e nxënësve.

Më poshtë janë disa aspekte kyçe të punës me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë:

- ***Diferencimi i mësimdhënies dhe materialeve***

Mësuesi duhet të diferencojë dhe të përshtatë metodat e mësimdhënies për të siguruar që të gjithë nxënësit të përfshihen në mësim dhe të mësojnë. Për këtë qëllim mund të përfshijë:

- *Përdorimin e materialeve vizuale.* Harta, diagramet, fotografitë dhe videot mund të ndihmojnë nxënësit që të kuptojnë më mirë konceptet gjeografike.

- *Thjeshtëzimin e përmbajtjes.* Për nxënësit që kanë vështirësi në kuptimin e informacionit të ngjeshur, mësimi mund të thjeshtohet dhe të strukturohet në mënyrë që të jetë më i lehtë për t'u kuptuar.

- ***Përshtatja e veprimtarive dhe detyrave***

Veprimtaritë dhe detyrat në lëndën e gjeografisë mund të ndryshojnë për të përmbushur nevojat e nxënësve me aftësi të ndryshme. Për shembull, nxënësit mund të punojnë në grupe të vogla, ku ata mund të mbështeten nga bashkëmoshatarët dhe të ndihmohen për të realizuar detyra të caktuara; disa nxënës mund të kenë nevojë për detyra më të thjeshta ose të tjera më vizuale, siç janë puna me hartat etj.

- ***Mbështetja individuale dhe mbikëqyrja***

Për nxënësit që kanë nevoja të veçanta, mund të jetë e nevojshme të ofrohet mbështetje e personalizuar gjatë mësimi. Mësuesi mund të ofrojë udhëzime të drejtpërdrejta dhe mbikëqyrje për t'i ndihmuar ata të kuptojnë materialin dhe të realizojnë detyrat e tyre. Nxënësit mund të kenë vështirësi të përballen me presionin e detyrave shkollore. Krijimi i një mjedisi mbështetës, ku ata ndjehen të sigurt dhe të motivuar, është shumë i rëndësishëm për suksesin e tyre. Puna në terren, studimi i hartave mund të kërkojnë mbikëqyrje të shtuar për nxënësit që kanë nevoja të veçanta, për t'u siguruar që ata po zhvillojnë veprimtaritë si duhet dhe që po përfitojnë nga mësimi.

- ***Përfshirja e teknologjisë dhe mjeteve të përshtatshme***

Përdorimi i teknologjisë mund të jetë shumë i dobishëm për nxënësit me nevoja të veçanta, pasi mund të ofrojë mundësi për të mësuar në mënyrë alternative dhe mund të jetë shumë më efektiv për individë që kanë vështirësi me materialet tradicionale. Nxënësit me vështirësi të kuptuarit të tekstit mund të përfitojnë nga videot edukative që shpjegojnë konceptet gjeografike në mënyrë të vizualizuar.

- ***Vlerësimi dhe përshtatja e metodave të vlerësimit***

Përshtatja e metodave të vlerësimit ndihmon në krijimin e një mjedisi të drejtë dhe të barabartë për nxënësit me nevoja të veçanta.

- ***Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës***

Një nga aspektet më të rëndësishme të punës me nxënësit me nevoja të veçanta është krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës. Ky mjedis ndihmon që nxënësit të mos ndjehen të ndarë ose të izoluar, por të përfshirë në procesin e mësimin. Mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm në ndihmën që ofrojnë, duke siguruar që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për të mësuar.

6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë

Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë ka për qëllim të stimulojë zhvillimin e aftësive të tyre dhe të krijojë mundësi për t'i sfiduar më tej në drejtim të njohurive dhe kompetencave gjeografike. Nxënësit e talentuar shpesh shfaqin interes të thellë dhe aftësi të shkëlqyera për të kuptuar dhe analizuar dukuritë gjeografike në një nivel më të lartë. Për të siguruar që këta nxënës të zhvillohen dhe të ruajnë nivelin e lartë të interesit dhe motivimit, është e rëndësishme që mësuesit të përdorin strategji të veçanta për t'i përfshirë ata në aktivitete të avancuara.

Disa ndër strategjitë e mësimdhënies me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë përfshijnë:

- *Diferencimi i mësimdhënies* është një strategji e rëndësishme për t'u siguruar që këta nxënës të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre. Për nxënësit e talentuar, mësuesi mund të ofrojë material që përfshin koncepte më të avancuara të gjeografisë; nxënësit mund të angazhohen në diskutime më komplekse dhe analiza të thelluara të çështjeve gjeografike; nxënësit mund të zhvillojnë projekte që kërkojnë hulumtime të thelluara mbi tema të zgjedhura nga ata.

- Nxënësit e talentuar mund të mësojnë të përdorin teknologji të avancuara për të analizuar të dhëna gjeografike dhe për të krijuar modele që mund të aplikohen në studimin e dukurive gjeografike. Softuerët si p.sh., Google Maps, Google Earth mund të ofrojnë mundësi shumë të mira për analizë dhe vizualizim të të dhënave.
- Nxënësit mund të angazhohen në veprimtari, si vizita në muze, pjesëmarrje në konkurse shkencore ose angazhimi në projekte komuniteti që përfshijnë zgjidhjen e problemeve mjedisore.
- Nxënësit mund të marrin pjesë në konkurse që lidhen me gjeografinë, si olimpiadat e gjeografisë, ku mund të konkurrojnë me të tjerë dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen të detajuara veprimtari praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi është pjesë thelbësore dhe integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve përmes teknikave të ndryshme të vlerësimit, të cilat ndihmojnë në matjen e arritjes së rezultateve të pritshme. Vlerësimi ka për qëllim të sigurojë një kuptim të qartë të progresit të nxënësve dhe të ofrojë informacione të vlefshme për përmirësimin e procesit mësimor. Me këtë informacion, mësuesi mund të marrë vendime të informuara për vlerësimin përfundimtar të nxënësve.

Përmes vlerësimit, mësuesi mund të përcaktojë nivelin e zhvillimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve dhe të sigurojë që të gjitha metodat e mësimdhënies të përshtaten në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të mësimdhënies. Po ashtu, vlerësimi u shërben nxënësve për të identifikuar aspektet ku mund të përmirësohen dhe për t'i motivuar për të arritur nivele më të larta. Në të njëjtën kohë, prindërit përfitojnë

nga ky informacion për të monitoruar progresin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre në shkollë, duke krijuar mundësi për mbështetje të vazhdueshme në shtëpi.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Kjo qasje mund të ndihmojë nxënësit të shohin se si njohuritë që po përvetësojnë mund të zbatohen në kontekste të jetës së përditshme. Përdorimi i konteksteve reale u ofron mundësi nxënësve të zhvillojnë aftësi analitike dhe praktike dhe i ndihmon ata të kuptojnë se gjeografia nuk është vetëm një disiplinë akademike, por një mjet i rëndësishëm për kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve të botës reale.

Më poshtë përshkruhen disa ndër parimet kryesore të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë:

- *Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i barabartë, duke u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë për të demonstruar tërësinë e dijeve, aftësive dhe mundësive të tyre.*
- *Vlerësimi duhet të ofrojë informacion mbështetës për nxënësin.*
- *Vlerësimi duhet të ushqejë aftësitë e nxënësve për të transferuar dijet e tyre në përvoja jetësore.*
- *Vlerësimi duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive dhe vetëvlerësimin e nxënësve për të reflektuar mbi të nxënit e tyre.*
- *Vlerësimi duhet të mundësojë shanse të barabarta për zhvillimin dhe përmirësimin e nxënësve.*
- *Vlerësimi duhet të përfshijë jo vetëm matjen, por dhe interpretimin e gjykimin.*
- *Vlerësimi duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë orës së mësimi dhe jo një moment në fund të saj.*
- *Vlerësimi duhet t'u komunikohet rregullisht prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve në një mënyrë sa më kuptimplotë.*

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve për t'u vlerësuar në atë mënyrë që është më e përshtatshme për aftësitë dhe nevojat e tyre individuale.

Llojet e vlerësimit në lëndën e gjeografisë

➤ *Vlerësimi diagnostikues (Vlerësimi si proces i nxënies)*

Ky lloj vlerësimi kryhet në fillim të vitit shkollor ose në fillim të një njësie të re të lëndës së gjeografisë. Mësuesi përdor këtë lloj vlerësimi për të zbuluar njohuritë që nxënësi ka mbi temat e mëparshme dhe për të identifikuar aspektet që kanë nevojë për përmirësim.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin diagnostikues përfshijnë:

- Pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për të kuptuar njohuritë paraprake të nxënësve.
- Ushtrime orientuese të shkurtra.
- Lojëra ose biseda reflektuese.
- Fisha vetëvlerësimi ku nxënësit reflektojnë mbi njohuritë dhe aftësitë e tyre të tanishme dhe identifikojnë fushat ku ndjehen më të dobët.

➤ *Vlerësimi formues (Vlerësimi i vazhduar, Vlerësimi për të nxënë)*

Ky vlerësim realizohet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, dhe ka për qëllim të monitorojë përparimin e nxënësve. Vlerësimi formues është një mundësi për të siguruar që nxënësit janë në rrugën e duhur dhe për të identifikuar çfarë duhet përmirësuar para se të arrihen rezultatet përfundimtare.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin formues përfshijnë:

- Vlerësimi i punës në grupe përmes aktiviteteve praktike, si puna me hartat, analiza e situatave gjeografike, apo studime rastesh.
 - Vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimit.
 - Detyrat dhe veprimtaritë përgjatë procesit mësimor.
 - Vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimit të zgjidhjeve.
 - Vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit, përmes pyetjeve që lidhen me konceptet gjeografike.
 - Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët nëpërmjet analizave dhe diskutimeve të veprimtarive që zhvillohen gjatë mësimit.
- **Vlerësimi përmbledhës** (*Vlerësimi periodik, Vlerësimi i të nxënës*)

Ky lloj vlerësimi realizohet pas një periudhe mësimore ose pas përfundimit të një kapitulli dhe ka për qëllim të matë atë që nxënësi ka arritur të mësojë gjatë një periudhe. Ky lloj vlerësimi është shpesh i lidhur me notën finale të nxënësit dhe ndihmon për të kuptuar progresin e nxënësit dhe aftësitë që ka zhvilluar në lidhje me temat e gjeografisë.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin përmbledhës përfshijnë:

- Teste me shkrim.
- Detyra individuale.
- Prezantim i produkteve të projektit.
- Raporte dhe ese që kërkojnë përdorimin e njohurive të marra gjatë periudhës mësimore për të argumentuar për një temë të gjeografisë.

Vlerësimi bazuar në nivele arritjeje

Vlerësimi bazuar në nivele arritjeje është një qasje thelbësore në mësimdhënien e gjeografisë; ndihmon në diferencimin e mësimdhënies dhe personalizimin e procesit të të nxënës për çdo nxënë.

Nivelet e arritjeve shprehin rezultatet e ndryshme që arrijnë nxënës të ndryshëm në përpjekjet e tyre për të përmbushur arritjen e dëshiruar (e pritshme) prej tyre në një lëndë. ***Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi të cilat duhet t'i shërbejnë progresit të nxënësit.***

Mësuesi duhet t'i krijojë çdo nxënësi mundësinë e të nxënësit në të gjitha nivelet, sikurse t'i japë mundësinë që të demonstrojë arritjet e tij. Kjo do të thotë që mësuesi:

- të mundësojë situata të nxënësi në përputhje me rezultatet e pritshme;
- të përzgjedhë veprimtari mësimore gjatë të cilave nxënësit demonstrojnë nivelin e tyre të arritjeve dhe i krijohet mundësi për progres;
- të vlerësojë nxënësit në përputhje me nivelet e tyre të arritjeve (performancën).

Në veçanti, nivelet e arritjeve ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar me nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxënësit e nxënësit.

7.1 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësit.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësit (RN-ve) në tematika të ndryshme.

Tabela 5. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull 1. Rezultati i të nxënësit (RN): Krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre			
<i>Niveli i arritjes: Shumë mirë</i>	<i>Niveli i arritjes: Mirë</i>	<i>Niveli i arritjes: Mjaftueshëm</i>	<i>Niveli i arritjes: Dobët</i>

Nxënësi krahason hartën, planin dhe globin dhe jep shpjegime të qarta dhe të argumentuara, duke përdorur terma gjeografikë të saktë; tregon aftësi për të analizuar, p.sh., përshkruan përparësitë dhe kufizimet e secilës (p.sh., globi paraqet me saktësi formën e Tokës, por nuk përfshin informacion të hollësishëm, ndërsa harta nuk tregon formën reale të Tokës, por përfshin më shumë elementë etj.).	Nxënësi identifikon dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis hartës, planit dhe globit; tregon me shembuj të thjeshtë, p.sh., "globi është sferik si Toka", "harta është e sheshtë"; përdor terminologji të saktë në mënyrë të përgjithshme.	Nxënësi përmend veçori të hartës, planit dhe globit, por nuk arrin të bëjë krahasimin; përdorimi i termave është jo i qëndrueshëm, ndonjëherë përdor terma të sakta, por i ngatërron; ka nevojë për pyetje nxitëse ose udhëzim për të ndërtuar krahasimin.	Nxënësi nuk jep informacion për veçoritë e hartës, planit dhe globit; demonstroi paqartësi në përdorimin e termave gjeografikë (p.sh., ngatërron globin me hartën ose nuk identifikon dallimet bazë); ka nevojë për ndihmë të vazhdueshme për të shprehur mendimet.
---	--	--	---

Shembull 2. Rezultati i të nxënit: Nxënësi përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton, duke dalluar grup moshat që dominojnë

<i>Niveli i arritjes: Shumë mirë</i>	<i>Niveli i arritjes: Mirë</i>	<i>Niveli i arritjes: Mjaftueshëm je:</i>	<i>Niveli i arritjes: Dobët</i>
Nxënësi jep një përshkrim të detajuar dhe të saktë të strukturës moshore të popullsisë në zonën ku jeton; dallon qartë grup moshat kryesore dhe	Nxënësi përshkruan strukturën moshore në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme; dallon grup moshat dominuese dhe i	Nxënësi përmend disa grup moshë të popullsisë në zonën e tij, por pa saktësi të plotë; përshkrimi është i kufizuar dhe pa shumë hollësi;	Nxënësi nuk arrin të përshkruajë strukturën moshore të popullsisë; nuk identifikon grup moshat që

analizon rolin e tyre në zhvillimin ekonomik, social ose kulturor të zonës; përdor me saktësi terminologji gjeografike (si p.sh., popullsi aktive) tregon aftësi për të menduar në mënyrë kritike dhe për të lidhur të dhënat me realitetin e përditshëm.	përmend saktë (p.sh., “Në zonën time dominojnë të rinjtë nën 30 vjeç”); tregon njohuri të mjaftueshme për përbërjen e popullsisë dhe përdor disa terma të duhur; mund të bëjë lidhje të thjeshta me ndikimin në komunitet (p.sh., në punësim).	identifikon një grup moshë dominuese, por pa e lidhur qartë me ndikimet që kjo ka në zone; ka nevojë për ndihmë për të shprehur mendimet dhe për të përpunuar të dhënat.	janë më të shumta në zonën ku jeton; jep informacione të pasakta ose të përgjithshme pa lidhje me realitetin; ka vështirësi në përdorimin e termave si: grup moshë, popullsi e re, popullsi e plakur etj.
---	--	--	---

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve sipas tematikave të lëndës.

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Përdorimi i mjeteve mësimore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve në lëndën e gjeografisë është thelbësor për konkretizimin e ideve, kuptimin e dukurive natyrore e shoqërore dhe zhvillimin e kompetencave gjeografike. Këto mjete ndihmojnë në ilustrimin vizual të temave, në nxitjen e mendimit kritik dhe krijes, si dhe në zbatimin më të efektshëm të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ato e bëjnë mësimin më dinamik, më të kuptueshëm dhe më tërheqës për nxënësit, duke rritur motivimin dhe angazhimin e tyre aktiv në klasë.

Zbatimi i suksesshëm i metodave dhe teknikave të mësimdhënies është i lidhur ngushtë me përdorimin e mjeteve didaktike të larmishme.

Mjetet mësimore mund të përfshijnë:

- Harta (fizike, ekonomike, administrative, topografike etj.), globi, atlas, albume, tablo, fotografi, skica, makete, diagramë, vjetarë statistikorë, manuale të të dhënave të elementeve klimatike, hidrografike, floristike, demografike etj.
- Mjete audio vizuale, si kompjuter, tablet, aparat projeksioni, aparat fotografik etj.
- Objektet natyrore janë mjete shumë efikase për të konkretizuar njohuritë e lëndës së gjeografisë. Në këtë grup futen koleksionet e ndryshme që krijohen me materiale të mbledhur nga natyra, si: gurë, minerale, drurë etj.
- Burime digjitale dhe interaktive: video demonstrative, filma dokumentarë që nxisin përfshirjen aktive të nxënësve, harta digjitale, kuize dhe lojëra edukative, platforma digjitale si Google Maps, Google Earth etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë dukurive gjeografike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv.

Roli i mësuesit në këtë proces është kyç. Përveç organizimit të mësimi, ai ka detyrën të krijojë një mjedis stimulues dhe mbështetës, ku nxënësit kanë akses të barabartë në burimet mësimore. Këto burime nuk kufizohen vetëm brenda klasës, por përfshijnë edhe mjedise jashtëshkollore që pasurojnë përvojën e nxënësit, si muzeu, objekte të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe monumente natyrore.

Në mënyrë të veçantë, teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) ka rritur mundësitë e nxënësve për të kërkuar informacione, për të eksploruar harta interaktive, për të përgatitur prezantime, si dhe për të zhvilluar projekte kërkimore të bazuara në fakte dhe të dhëna gjeografike të përditësuara.

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhet më në detaje përdorimi i burimeve dhe materialeve didaktike, përfshirë teknologjinë.

9 REKOMANDIME TË TJERA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Zbatimi me sukses i programit të gjeografisë kërkon një qasje të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar, duke pasur në qendër nxënësin dhe zhvillimin e tij të plotë.

➤ *Lidhja e gjeografisë me lëndët dhe fushat e tjera*

Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore. Ajo ndihmon nxënësit të kuptojnë botën ku jetojnë, duke analizuar marrëdhëniet midis mjedisit natyror dhe veprimtarisë njerëzore. Kjo e bën gjeografinë një pikë kyçe ndërlidhëse me lëndë dhe fusha të tjera të kurrikulës.

Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi për integrimin ndërlëndor:

Të identifikojë temat e përbashkëta me lëndët e tjera.

Gjeografia ka shumë pika takimi me historinë, biologjinë, qytetarinë, matematikën, shkencat e natyrës, teknologjinë dhe artet. Mësuesi duhet të planifikojë mësimin duke evidentuar këto lidhje, për shembull:

- Ndryshimet klimatike (gjeografi dhe shkenca natyrore).
- Trashëgimia natyrore dhe kulturore (gjeografi, histori dhe qytetari).
- Përdorimi i hartave dhe shkallës (gjeografi dhe matematikë).
- Projekte me përdorimin e teknologjisë (gjeografi dhe TIK.)

Të punojë në bashkëpunim me mësuesit e tjerë.

Planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta, projekteve integruese ose orëve të hapura me mësues të fushave të tjera pasuron përvojën e nxënësit dhe forcon të kuptuarit shumëdimensional të temave.


Të shmangë fragmentimin e njohurive.

Mësuesi duhet të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se dijet nuk janë të ndara në "kuti", por lidhen me njëra-tjetrën dhe me jetën reale. Kjo forcon aftësitë e të menduarit kritik dhe transferimin e njohurive.

➤ *Zbatimet e lëndës në jetën reale dhe lidhja me tregun e punës dhe orientimin për karrierën*

Njohuritë dhe kompetencat e zhvilluara përmes gjeografisë janë thelbësore për jetën e përditshme dhe të përdorshme në një gamë të gjerë profesionale. Ato ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë botën që i rrethon dhe të marrin vendime të informuara. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të shohin vlerën e gjeografisë jo vetëm si një lëndë shkollore, por si një **mjet për jetë, karrierë dhe qytetari aktive**.

Orientimi në hapësirë, përdorimi i hartave dhe të dhënave gjeografike janë aftësi të dobishme në udhëtime, planifikim urban, hartim politikash mjedisore dhe menaxhim të emergjencave. Një sërë profesionale janë të lidhura me gjeografinë si planifikues urban, ekolog, meteorolog, gjeolog, guidë turistike, specialist mjedisor, menaxher turizmi etj.



➤ *Ndërlidhja e gjeografisë me qasjen STEM*

STEM është një qasje ndërdisiplinore që përfshin Shkencën, Teknologjinë, Inxhinierinë dhe Matematikën. Gjeografia, si një shkencë natyrore dhe shoqërore, ka lidhje të ngushta me të gjitha komponentët e STEM.

Me shkencat e natyrës: Gjeografia përdor metoda shkencore për të kuptuar dukuritë natyrore (ndryshimet klimatike, tërmetet etj.) dhe për të hulumtuar mbi ndikimin e aktivitetit njerëzor në mjedis.

Me teknologjinë: Përdorimi i GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), fotografive ajrore, imazheve satelitore etj., në analizën e hapësirës, përdorimi i aplikacioneve dhe platformave digjitale për të paraqitur dhe analizuar të dhëna gjeografike.

Me inxhinierinë: Planifikimi urban, ndërtimi i infrastrukturës në përputhje me karakteristikat gjeografike, vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe përcaktimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.

Me matematikën: Analiza statistikore e të dhënave gjeografike (të dhënat për popullsinë, sasinë e reshjeve, temperaturën e ajrit etj.), matja e distancave, përlllogaritja e sipërfaqeve, ndërtimi i grafikëve dhe hartave.



➤ *Rekomandime për autorët e teksteve shkollore*

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të përfshijnë në tekstet shkollore veprimtari që nxisin zhvillimin e aftësive të mendimit kritik e krijues, zgjidhjes së problemeve, përdorimit të teknologjisë, kërkimit gjeografik dhe bashkëpunimit.
- Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe veprimtari që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku gjeografia luan rol.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën.

10 NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE

Programi mësimor i lëndës së gjeografisë për klasën e gjashtë është përditësuar dhe përfshin ndryshimet e mëposhtme:

- Përditësimi i kompetencave kyçe dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e gjashtë.
- Përditësimi i kompetencave të lëndës së gjeografisë dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e gjashtë.
- Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
- Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, krijues zgjidhjen problemore duke përfshirë ndërlidhjen me qasjen STEM, përdorimin e teknologjisë etj.
- Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.
- Vendosja e fokusit në situatat praktike të të nxënit duke e fokusuar rreth 40% të procesit mësimor në veprimtari konkrete praktike, duke krijuar përvoja që i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë lidhje mes teorisë dhe praktikës. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- Përditësimi i përmbajtjes me përfshirjen e rezultateve të të nxënit të cilat vendosin më në fokus temat ndërkurrikulare, si çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe aftësitë e të menduarit kritik e krijues, zgjidhjes së problemeve, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vazhdim janë prezantuar këto rezultate të nxëni sipas nën tematikave përkatëse.

a) Hartat gjeografike

Nxënësi:

- *Përdor mjete digjitale për të kërkuar dhe eksploruar harta të ndryshme, si p.sh., harta fizike, administrative, klimatike, demografike etj., me qëllim njohjen e llojeve të hartave dhe kuptimin e mënyrës se si ato përdoren për të interpretuar informacionin gjeografik;*

b) Mjedisi ynë lokal

Nxënësi:

- *Demonstron orientimin në terren duke përdorur elementet natyrore, si p.sh., Diellin, myshqet në pemë, rrathët e drurëve të pemëve etj., për të përcaktuar drejtimit kryesore të horizontit në mjedisin lokal;*
 - *Dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij dhe si ato janë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si p.sh., faktorët klimatikë, urbanizimi, zhvillimi industrial etj.*
 - *Diskuton mbi rrugët e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonës në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore.*
 - *Kërkon dhe përdor materiale digjitale (p.sh., foto, video nga interneti ose të realizuara vetë) që tregojnë si veprimet e njerëzve ndikojnë në natyrë, duke interpretuar ndryshimet e vërejtura dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.*
 - *Krijon një prezantim të thjeshtë (p.sh., me PowerPoint ose aplikacione të tjera) për të treguar ndikimin e ndryshimeve klimatike ose të problemeve mjedisore (p.sh., ndotja) në qytetin/fshatin e tij.*
- Lidhja e gjeografisë me zbatimet e lëndës në jetën reale dhe lidhja me tregun e punës dhe orientimin për karrierën. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të shohin vlerën e gjeografisë jo vetëm si një lëndë shkollë, por si një mjet për jetë, karrierë dhe qytetari aktive. Orientimi në hapësirë, përdorimi i hartave dhe të dhënave gjeografike janë aftësi të dobishme në udhëtime, planifikim urban, hartim politikash mjedisore dhe menaxhim të emergjencave. Një sërë profesioneesh janë të lidhura me gjeografinë si gjeograf, meteorolog, planifikues urban, guidë turistike, specialist mjedisor, menaxher turizmi etj.